



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura V  
*Sesioni pranveror*

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.45/2017

Prishtinë, më 24 janar 2017

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Etem Arifi, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyçi dhe Kujtim Paqaku.

Mungoi: Nenad Rashiq.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinatori i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës, Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit (UNICEF).

Pjesëmarrës të tjerë: Blerim Uka, Donika Sherifi- Indeksonline; Albulena Misini-Ekonomia-online; Hajrudin Skënderi-Ambasada e Zvicrës; Eugen Cakolli-KDI; Sanije Berisha-OSBE; Donjetë Kelmendi-KOMF; Alketa Lasku-Terre Des Hommes; Fellanza Knusha-CSGD; Shpresa Dresha-QESH; Agim Margilaj-CSGD.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Anëtarët e Komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit, andaj në vazhdim, Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

**Rend dite:**

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës për vitin 2016;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës për vitin 2017;
4. Shqyrtimi i peticioneve;
5. Të ndryshme.

\*\*\*

## **1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme**

Kryetarja konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 16 nëntor, 23 nëntor dhe 7 dhjetor 2016, u miratuan pa vërejtje.

## **2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës për vitin 2016**

**Kryetarja**, tha se në raport është pasqyruar puna që është bërë në Komision, ka pasur ndonjë ngecje në realizimin e planit të punës, por nuk janë varur të gjitha nga Komisioni. Pra, dihet se Projektligji për ndryshim plotësimin e Ligjit për lirinë fetare, ende nuk ka kaluar në parim në Kuvend dhe është një projektligj me interes vital dhe kërkon votat edhe të minoritetit serb. Po ashtu, kryetarja theksoi se ka disa propozime lidhur me aktivitetet e zhvilluara nga ana e saj, të cilat do t'i paraqesë në administratën e Komisionit, për pasqyrim në raport. Ajo tha se cilido nga anëtarët e Komisionit që kanë ndonjë propozim për të plotësuar raportin, mund ta bëjnë këtë.

Kryetarja hapi diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës.

**Teuta Haxhiu**, tha se ky raport është përmbledhës. Në të pasqyrohen aktivitetet që ka zhvilluar Komisioni, dhe si të tillë, nuk ka diçka për të plotësuar.

**Mexhide Mjaku-Topalli**, tha se nuk ka ndonjë vërejtje në këtë raport, por theksoi se duhet të evidentohet punësoria që është realizuar në Durrës, për shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtjen e fëmijës.

**Shukrije Bytyçi**, tha se edhe pse i është bashkangjitur këtij Komisioni në muajin nëntor, e mbështet punën e pasqyruar në këtë raport dhe është mirë të jetë gjithëpërfshirës.

**Kujtim Paqaku**, tha se në Raportin e punës së Komisionit për vitin 2016, vlen të përmendet sukcesi i vizitave nëpër njësitë komunale, zyrat për komunitete, ku edhe kanë pasur efekt të mirë.

Nga viti 2016, do të duhej një raport i posaçëm lidhur me sfidat dhe të arriturat e pjesëtarëve të komuniteteve. Ai theksoi se edhe në vitin 2017, t'i vizitojmë komunat e njëjta dhe të shohim se a ballafaqohen me probleme të njëjta dhe a kanë lindur probleme të reja. Në fund, theksoi se kemi informata se qeveritë lokale ende nuk kanë siguruar buxhet për të riatdhesuarit.

**Mytahir Haskuka**, tha se vitin e kaluar nuk ka ecur mirë, kemi shqyrtuar disa peticione, por në përgjithësi, punën e peticioneve duhet trajtuar më shumë, kemi shqyrtuar 8 peticione. Duhet rregulluar çështja e shqyrtimit të peticioneve dhe të krijojmë standarde të njëjta, sepse prej peticionit në peticion, po krijojmë standarde të ndryshme, ndoshta me një peticion individual po merremi më shumë se me një peticion të cilin e kanë nënshkruar me mijëra qytetarë.

**Lirije Kajtazi**, tha se për punën e peticioneve, ne kemi dërguar emrin e anëtares sonë në Komisionin për Legjislacion, në mënyrë që kur të shqyrtohet rregullorja e re e Kuvendit, për punën e shqyrtimit të peticioneve, të diskutohet edhe kjo çështje, sepse asokohe na është sugjeruar që draft-udhëzuesin që e kemi përgatitur, duhet të jetë në harmoni me rregulloren e re të Kuvendit.

Pas diskutimeve, kryetarja hodhi në votim miratimin e Raportit të punës së Komisionit për vitin 2016, me vërejtjet dhe plotësimet që u dhanë nga anëtarët e Komisionit.

Kryetarja konstatoi se Komisioni, unanimisht, miratoi Raportin e punës së Komisionit për vitin 2016, me vërejtjet dhe plotësimet që u dhanë nga Komisioni.

### **3.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës për vitin 2017**

**Kryetarja**, tha se në këtë plan të punës, ka edhe detyra të bartura nga viti 2016, po ashtu është me rëndësi të evidentohen edhe sfidat që janë te Raporti i Progresit, në mënyrë që ato të barten si aktivitete tona.

Kryetarja hapi diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës.

**Teuta Haxhiu**, tha se kam shikuar me kujdes Planin e punës për vitin 2017 dhe ka disa sugjerime. Sa i përket plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit për personat e zhdukur, me draft-planin e punës, është paraparë të fillojë në muajin korrik, por nevoja për të ndryshuar dhe plotësuar këtë projektligj, është parë qysh mandatin e kaluar, andaj kërkoi që kjo punë të fillojë në muajin mars 2017, në mënyrë që deri më 27 prill, kur është Dita e të Pagjeturve, Komisioni, në këtë drejtim, të jetë sa më i përgatitur.

Më tej, ajo u ndal te terminologjia e përdorur, sa i përket shprehjes viktimë civile e luftës, e cila gjendet në Ligjin nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre, duke theksuar se ajo shprehje nuk është e përdorur në mënyrën e duhur, sepse, ne, sa herë marrim pjesë nëpër akademi përkujtimore, atyre u drejtohem me shprehjen “të nderuar familjarë të martirëve”, ndërsa me ligj kjo kategori trajtohet se është viktimë civile, që sipas bindjeve të mia, ky term është i pakuptim.

Në vazhdim, ajo tha se kur t'i bëjmë vizitat në njësitë për të drejtat e njeriut në komuna, mendoj se duhet të bëjmë vizitë edhe në shtëpitë e komuniteteve dhe personave me të meta mendore, për të parë si trajtohen këta persona, në përgjithësi, por edhe në aspektin se sa ndahet buxhet për ta.

Sa i përket draft-udhëzuesit për peticione, ajo vlerësoi se është bërë një punë shumë e mirë dhe ai udhëzues do të na kishte ndihmuar shumë në shqyrtimin e peticioneve. Si Komision, të bëjmë presion që ky draft-udhëzues të procedohet sa më parë që është e mundur.

**Mexhide Mjaku-Topalli**, propozoi që takimi me Komisionin Qeveritar për Personat e Zhdukur, të mbahet më 30 janar 2017, sepse ka shumë shqetësime lidhur me këtë çështje dhe

do të vlerësojmë sesi do t'u qasemi punëve të mëtutjeshme, në këtë drejtim. Edhe në Raportin e Progresit i është dhënë prioritet kësaj çështjeje.

Sa i përket monitorimit të ligjeve, është mirë të mbikëqyrim Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi dhe Ligjin për barazi gjinore, ndërsa në Raport të Progresit, është e evidentuar se mungon sistemi i mbledhjes së të dhënave në të gjitha institucionet, pra është mirë t'i kemi parasysh këto dhe t'i monitorojmë këto ligje.

**Salihe Mustafa**, tha se mbështet propozimin që nisma për plotësim-ndryshimin e Ligjit për personat e zhdukur, të fillojë më herët.

Në draft-planin e punës është paraparë monitorimi i Ligjit për statusin dhe te drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, ndërsa ne, ende nuk kemi informatë a është ndarë buxheti për implementimin e këtij ligji. Para miratimit të buxhetit në Kuvend, Komisioni ynë ka kërkuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, të parashohë ndarjen e mjeteve për zbatim të këtij ligji. Të kërkohet nga MEF, informata se a janë ndarë mjete për zbatimin e këtij ligji dhe pastaj është në rregull që të merremi edhe me mbikëqyrjen e zbatimit të tij.

**Lirije Kajtazi**, tha se meqë ky ligj ka hyrë në fuqi, kjo të mbetet në planin e punës dhe nëse nuk është ndarë buxheti, ne të insistojmë për ndarje të buxhetit për zbatim të tij.

**Kujtim Paqaku**, insistoi që të kemi raportet nga zyrat për komunitetet, për ato komuna që kemi vizituar, së pari për të parë të arriturat e tyre. Po ashtu ,mendoj se krahas vizitave të njësitit komunal për të drejtat e njeriut, të vizitohen edhe zyrat për kthim dhe komunitetet. Për rezultatet dhe sfidat, nga ato raporte, mund të shërbejnë edhe në çështjen e zbatimit të MSA-së, gjatë raportimeve që pritet të ketë në Komisionin për MSA-në, anëtar i të cilit komision është.

**Shukrije Bytyçi**, tha se përkrah, në veçanti, monitorimin e Ligjit për barazi gjinore, por edhe vizitat në njësitë për të drejtat e njeriut nëpër komuna, sepse ato thuhet janë jofunksionale dhe është mirë të shihen përgjegjësitë. Vizitat në njësinë e të drejtave të njeriut, të bëhen në 7 rajonet e Kosovës. Ajo propozoi të vizitohet shkolla për të verbrit në Pejë dhe të shurdhrit në Prizren, dhe nëse ka shkolla të tilla edhe në komuna të tjera, sepse kam informacione se bëhet shkelje e të drejtave të njeriut aty dhe ende nuk e kanë literaturën adekuate bazë. Ajo tha se edhe bizneset private po bëjnë shkeljen e të drejtave të njeriut për punëtorët, të cilët bëjnë punë pa orar dhe askush nuk e merr atë përgjegjësi, dhe nëse është e mundur, edhe këtu të bëjmë një mbikëqyrje.

**Mexhide Mjaku-Topalli**, tha se në këtë vit, të fokusohemi më shumë edhe për strehimoret që janë të vendosura femrat që kanë përjetuar dhunë, por edhe në strehimoret e fëmijëve që janë viktima të dhunës. Po ashtu, është mirë që të bëjmë një takim me ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, sepse kemi shumë çështje për të diskutuar, përfshirë edhe çështjen e Ligjit për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si dhe për Ligjin për mbrojtjen e fëmijës.

**Lirije Kajtazi**, tha se ministri është i gatshëm t'i përgjigjet Komisionit, kurdo që e ftojme në takim.

Sa i përket vizitave nëpër komuna, ajo theksoi se zyrat për komunitete dhe kthim janë kompetencë e Komisionit parlamentar për Kthim dhe Komunitete.

**Mytahir Haskuka**, propozoi që të bëhet monitorimi i zbatimit të ligjeve të pakos së të drejtave t; njeriut, Ligjit për Avokatin e Popullit, Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe Ligjit për barazi gjinore. Ai propozoi që të mbahet një konferencë me Inspektoratin e Punës, për të parë se si zbatohet Ligji i punës, në aspektin e mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve. Në lidhje me gjendjen e të drejtave të fëmijëve dhe dhunën që bëhet ndaj tyre, ai theksoi se do të ishte mirë të angazhojmë ndonjë ekspert të ndonjë organizate mbështetëse, për të na ofruar ndonjë raport për këtë çështje.

Ndërsa, sa i përket zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, ato ministri që nuk kanë marrë pjesë në tryezën mbi zbatimin e rekomandimeve që dalin nga Raporti i IAP-it për vitin 2015, do të duhej që raportet t'i sjellin me shkrim.

**Lirije Kajtazi**, theksoi se sa i përket aktiviteteve lidhur me 8 Marsin- Ditën Ndërkombëtare të Gruas, ato duhet t'i harmonizojmë me Kryetarin e Kuvendit, me qëllim që të jemi të akorduar në aktivitete dhe agjendën konkrete.

**Mexhide Mjaku-Topalli**, lidhur me aktivitetet që do të realizohen në muajin maj, kërkoi që këtë vit të realizohet vizita në burgun e Dubravës, sepse në vitin e kaluar, një gjë e tillë nuk ka ndodhur nga Komisioni.

**Teuta Haxhiu**, propozoi që në aktivitetet e Komisionit për muajin korrik, të futet monitorimi i ndonjërit nga ligjet që është në plan të Komisionit.

**Lirije Kajtazi**, lidhur me këtë propozim, theksoi se do të jetë mirë t'i monitorojnë të tria ligjet e pakos për të drejtat e njeriut, të cilat bashkërisht i ka amendamentar Komisioni.

**Mytahir Haskuka**, propozoi që në muajin maj të futet takimi me Inspektoratin e Punës, lidhur me monitorimin e të drejtave të punëtorëve.

Pas këtyre diskutimeve, Komisioni, me votim unanim, miratoi Planin e punës për vitin 2017, me propozimet e paraqitura.

#### **4. Shqyrtimi i peticioneve**

**Teuta Haxhiu**, para se të fillonin me shqyrtimin e peticioneve, kërkoi që të harmonizohen qëndrimet e Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Komisionit për Legjislacion, sa i përket draft-udhëzuesit për shqyrtimin e peticioneve.

**Lirije Kajtazi**, lidhur me këtë çështje, theksoi se do të jetë e rëndësishme që, si Komision, ta dërgojnë një shkresë tek Komisioni për Legjislacion, sepse vonesat në këtë drejtim po sjellin probleme në praktikë, tek Komisioni për të Drejtat e Njeriut, sa i përket procedurës së shqyrtimit të peticioneve.

\*\*\*

Në vazhdim, ajo i njoftoi anëtarët e Komisionit se Shukri Maxhuni, në emër të 10 mijë nënshkrimeve të mbledhura nga qytetarët, ka paraqitur një kërkesë, në bazë të së cilës ka kërkuar ndryshimin e Ligjit për shitjen e banesave. Ajo, po ashtu, theksoi se këtë çështje ai e ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese.

**Teuta Haxhiu**, kërkoi sqarime për këtë çështje, me qëllim të informimit se a është dërguar çështja në Gjykatë Kushtetuese apo pala ka kërkuar nga Komisioni që këtë çështje ta dërgojë në Gjykatë Kushtetuese.

**Mytahir Haskuka**, lidhur me këtë çështje, theksoi se pala e ka dërguar çështjen në Gjykatën Kushtetuese dhe për këtë nuk ka kërkuar asgjë nga Komisioni, kurse duhet të presin se çka do të vendosë Gjykata, e pastaj të veprojnë si Komision, sepse në këtë fazë, nuk është kërkuar ndonjë veprim konkret nga Komisioni.

**Mexhide Mjaku-Topalli**, tha se qytetarët kanë kërkuar të drejtën për blerje të banesave, mirëpo atyre, përveç që nuk po iu lejohet blerja e banesave, komuna nuk i ka kompensuar shpenzimet e domosdoshme, të cilat janë investuar në objektet banesore nga qytetarët, me qëllim të aftësimin të tyre për banim. Kjo është e drejtë ligjore e cila iu takon atyre.

**Etem Arifi**, tha se lënda në fjalë është e paqartë. Pasi që çështja është dërguar në Gjykatën Kushtetuese, ai ishte i mendimit që të presin deri në marrjen e vendimit nga Gjykata, e pastaj të veprojnë si Komision, sepse në këtë fazë është e pamundur.

**Salihe Mustafa**, theksoi se parashtruesit e kërkesës, t'i kthehet kërkesa dhe të kërkohet nga ana e tyre që ta precizojnë kërkesën, sepse kërkesa aktuale është konfuze dhe Komisioni e ka të paqartë se çka duhet të ndërmarrë.

Pas diskutimeve, lidhur me këtë çështje, Komisioni vendosi që administrata, përmes një shkrese, të kërkojë sqarime nga IAP-i, për të konstatuar nëse një kërkesë e tillë i është adresuar edhe Avokatit të Popullit.

Pas marrjes së sqarimeve nga IAP-i, kjo çështje dhe Peticioni i ish-punëtorëve të KEDS-it, të shqyrtohen përsëri në mbledhje të Komisionit.

## **5. Të ndryshme**

**Mexhide Mjaku-Topalli**, njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me aktivitetet e grupit të punës për shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtjen e fëmijëve.

Ajo tha se janë inkorporuar propozimet e paraqitura dhe në vazhdim do të mbahen takime të grupit të punës dhe pastaj projektligji do të përcillet për miratim në Komision.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 12:15.

*E përgatiti:*

*Stafi Mbështetës i Komisionit.*

Kryetarja e Komisionit,

---

Lirije KAJTAZI